



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 qershor 2026
Nr. ref.: AGJ3115/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI296/25

Parashtrues

Muhamet Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në lëndën civile C.
nr. 896/2024 nga Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Muhamet Morina, me banim në fshatin Radostë, komuna e Rahovecit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Korab Bokshi, avokat në komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore, e cila zhvillohet në Gjykatën Themelore në Gjakovë – dega në Rahovec (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) në lidhje me lëndën civile [C. nr. 896/2024].

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës që zhvillohet në Gjykatën Themelore, me pretendimin se mosvendosja e së njëjtës në lëndën [C. nr. 896/2024] cenon të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me dispozitat e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës nr. 01/2023 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 22 shtator 2025, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përmes postës elektronike kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 6 tetor 2025, Kryetari i Gjykatës, me vendimin [GJR. KI296/25] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues ndërsa me vendimin [KSH. KI296/25] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
7. Më 14 korrik 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 28 tetor 2025, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës informata shtesë në lidhje me ankesën e tij kushtetuese, dhe dorëzimin e dokumentacionit përcjellës, përkatësisht:

„(i) A ka marrë formë të prerë Aktgjykimi [C. nr. 221/79] i 25 shtatorit 1986 i Gjykatës Komunale në Rahovec, apo i njëjti është kundërshtuar me mjet të rregullt juridik ? Nëse po, është e nevojshme të sqarohet rrjedha e mëtejshme e tij dhe të dorëzohet dokumentacioni përcjellës.

(ii) Cili është thelbi i kërkesës së 9 prillit 1990 drejtuar Gjykatës Komunale në Rahovec nga ana e parashtruesit të kërkesës në lidhje me lëndën [C. nr. 420/88]?

(iii) Kur është iniciuar procedura në lidhje me lëndën [C. nr. 420/88], e cila ka qenë objekti i kontestit, cilat kanë qenë palët dhe kërkesëpadia e paditësit – si dhe cilat veprime i ka ndërmarrë Gjykata Komunale në lidhje me këtë procedurë? Është e nevojshme të dorëzohet dokumentacioni përkatës.

(iv) Çfarë natyre ka Kërkesa [C. nr. 44/06] e 7 marsit 2011, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komunale në Rahovec nga ana e parashtruesit të kërkesës, dhe kur është iniciuar procedura sipas shenjës [C. nr. 44/06] – duke pasur parasysh se me

*Aktgjykimin [C. nr. 221/79] të 25 shtatorit 1986 të Gjykatës Komunale në Rahovec, parashtruesit të kërkesës tashmë i është njohur e drejta e pronësisë?
(v) Cilat janë veprimet procedurale të ndërmarra nga ana juaj dhe nga ana e përfaqësuesve të mëparshëm të parashtruesit të kërkesës me qëllim të përshpejtimin të procedurës në Gjykatën Komunale, përkatësisht Gjykatën Themelore?”*

9. Më 5 nëntor 2025, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës informacione të paplota në lidhje me pyetjet e parashtruara, përkatësisht sqarimet e kërkuara. Konkretisht, i njëjti nuk ka dhënë fare shpjegim lidhur me pyetjen e parë (i), e cila ka të bëjë me formën e prerë të Aktgjykimit [C. nr. 221/79] të 25 shtatorit 1986 dhe rrjedhën e tij të mëtejshme procedurale; me pyetjen e tretë (iii), e cila i referohet lëndës [C. nr. 420/88], përkatësisht objektit të kontestit dhe veprimeve të ndërmarra nga ana e gjykatës; si dhe me pyetjen e pestë (v), e cila ka të bëjë me veprimet e ndërmarra gjatë tërë procedurës gjyqësore me qëllim të përshpejtimin të saj. Sa i përket dokumentacionit të kërkuar, parashtruesi i kërkesës përsëri i ka dorëzuar Gjykatës të njëjtat shkresa që tashmë i ishin bashkëngjitur ankesës kushtetuese, përkatësisht kërkesën e 4 prillit 1990 për vazhdimin e procedurës dhe kërkesën e 7 marsit 2011 drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komunale në Rahovec.
10. Më 3 dhjetor 2025, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe rekomandoi që raporti të plotësohet.
11. Më 17 dhjetor 2025, Gjykata kërkoi informata shtesë në lidhje me lëndën [C. nr. 896/2024] nga Gjykata Themelore, përkatësisht:

„(a) Për cilën kërkesëpadi Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec mbajti shqyrtim paraprak . Më konkretisht, kur/në cilin vit u parashtrua kërkesëpadia në lidhje me rastin në fjalë në Gjykatën Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec?

(b) Cili ishte objekti i kërkesëpadisë mbi bazën e të cilit Gjykata Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec mbajti shqyrtim paraprak më 14 tetor 2022?”

12. Më 24 dhjetor 2025, Gjykata Themelore dorëzoi përgjigjen e saj ndaj pyetjeve të bëra.
13. Më 28 prill 2026, Kolegji shqyrtues shqyrtoi versionin e plotësuar të raportit të gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi që (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; dhe (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]]të Kushtetutës dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm.

Përmbledhja a fakteve

14. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se procedura gjyqësore është iniciuar nga parashtruesi i kërkesës në vitin 1978, përmes padisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrat kadastrale [nr. 968/1, 975/1 dhe 1089/3], të cilat i përkasin zonës kadastrale Radostë, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurve Haxhi Lushi, Muharrem Lushi dhe Halit Lushi.
15. Më 25 shtator 1986, Gjykata Komunale në Rahovec (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Komunale) nxori Aktgjykimin [C. nr. 221/79], përmes të cilit aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe vërtetoi se i njëjti është pronar i ngastrave 971/1 dhe 1089/3, ZK

Radostë, si dhe i ka obliguar të paditurit t'i njohin parashtruesit të kërkesës të drejtën e pronësisë mbi ngastrat e lartpërmendura.

16. Më tej, rezulton se më 9 prill 1990 parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Komunale kërkesë për vazhdimin e procedurës së ndërprerë me shenjë [C. nr. 420/88]. Gjithashtu, sipas dokumentacionit të dorëzuar bashkë me ankesën kushtetuese, më 9 mars 2011, parashtruesi i kërkesës iu drejtua kryetarit të Gjykatës Komunale me një kërkesë për parandalimin e pretenduar të pengimit të posedimit mbi ngastrat kadastrale për të cilat ai pretendonte se ishin pronë e tij.
17. Ndërkohë, bazuar në shkresat në dispozicion, lënda ka marrë një shenjë të re [C. nr. 47/2019], dhe se seanca përgatitore është mbajtur më 14 tetor 2022. Seanca e radhës përgatitore është mbajtur më 8 nëntor 2022, në të cilën me një aktvendim procedural të formës së prerë procedura është ndërprerë për shkak të vdekjes së palëve të paditura.
18. Po ashtu, në seancën e radhës përgatitore të mbajtur më 11 gusht 2023, e cila është zhvilluar me shenjë të re [C. nr. 721/2022], me një aktvendim procedural të formës së prerë procedura është ndërprerë sërish për shkak të të paditurve tjerë të cilët ndërkohë janë identifikuar dhe të cilët gjithashtu kanë vdekur.
19. Më 12 qershor 2024, Gjykata Themelore nxori aktvendimin [C. nr. 616/2023], me të cilin sërish ka ndërprerë procedurën për shkak të vdekjes së njërit prej të paditurve.
20. Më 4 tetor 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën Themelore kërkesë për vazhdimin e procedurës së ndërprerë, me arsyetimin se janë plotësuar kushtet për vazhdimin e mëtejshme të procedurës.
21. Nga dokumentacioni përcjellës rezulton se gjyqtari i ngarkuar me lëndën, F.B., më 4 dhjetor 2024, kërkoi përmes postës elektronike nga Shërbimi i regjistrit amë të Komunes së Rahovecit lëshimin e ekstrakteve nga regjistri i të vdekurve për palët e paditura, me qëllim të identifikimit të saktë të pjesëmarrësve në procedurë. Megjithatë, Shërbimi i regjistrit amë objektivisht nuk ka mundur të kryejë identifikimin e personave në cilësinë e trashëgimtarëve të palëve të paditura, të cilët ndërkohë kanë vdekur.
22. Më 6 dhjetor 2024, Gjykata Themelore nxori aktvendimin [C. nr. 896/2024], me të cilin është refuzuar propozimi i parashtruesit për vazhdimin e procedurës, dhe është vërtetuar aktvendimi [C. nr. 616/2023] i 12 qershorit 2024 i së njëjtës instancë gjyqësore.
23. Gjykata Themelore arsyetoi se parashtresa, përkatësisht propozimi i parashtruesit për vazhdimin e procedurës, është *“për nga përmbajtja jo serioz”* dhe se identifikimi i palëve në cilësinë e të paditurve është përgjegjësi e vetë paditësit [përkatësisht parashtruesit të kërkesës], *„pasi që ka interes juridik për vazhdimin e kësaj procedure dhe i njëjti ka mundësi që vet të siguroj aktin e vdekjes nga regjistri amë i të vdekurve“*.
24. Po ashtu, Gjykata Themelore theksoi se, megjithëse e njëjta në procedurën kontestimore ka një rol pasiv, ka qenë e angazhuar në drejtimin e lëndës *„duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për sigurimin e ekstrakteve nga regjistri amë i të vdekurve, edhe pse kjo nuk është detyrimi i saj“*.
25. Më 31 dhjetor 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi në Gjykatën e Apelit ankesë kundër aktvendimit [C. nr. 896/2024] të 6 dhjetorit 2024 të Gjykatës Themelore, për shkak të: (i) shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, (ii) vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe (iv) vendimit për shpenzimet e procedurës.

26. Bazuar në shkresat e lëndës dhe informacionet e dorëzuara, rezulton se kontesti në fjalë aktualisht ndodhet në procedurë në Gjykatën e Apelit, e cila ende nuk ka marrë vendim lidhur me ankesën e parashtruar më 31 dhjetor 2024.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës në rastin që shqyrtohet në Gjykatën Themelore [C. nr. 896/2024] cenon të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se procedura gjyqësore e cila është ende në vazhdim, përkatësisht e cila nuk është përfunduar, *„zgjat mbi 40 vite dhe është në kundërshtim të qartë me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për një gjykim të drejtë dhe brenda një afati të arsyeshëm“*.
29. Në këtë kontekst, ai theksoi se Gjykata Themelore *„nuk ka marrë masa efektive për ta finalizuar procedurën“*. Parashtruesi i kërkesës ka shprehur veçanërisht pakënaqësinë për shkak të refuzimit të Gjykatës Themelore për të vazhduar procedurën bazuar në kërkesën e tij, duke theksuar se, *„arsyetimi i gjykatës se nuk janë siguruar dokumentet pranë zyrës civile për trashëgimtarët e të paditurve, është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe me obligimin pozitiv të gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi gjyqësor efektiv“*.
30. Në këtë drejtim, parashtruesi i kërkesës theksoi se *„nuk ka qenë në gjendje të ndikojë në vonesat e shkaktuara nga rrethanat objektive (vdekja e palëve, procedurat e trashëgimisë)“*, sepse, sipas vlerësimit të tij të njëanshëm, *„gjykata është institucioni përgjegjës për të organizuar procesin në mënyrë efikase, pa e zvarritur atë për periudha të gjata“*.

Komentet e pranuar nga Gjykata Themelore

31. Në lidhje me rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata kërkoi informata nga Gjykata Themelore. Në përgjigjen e Gjykatës Themelore të 24 dhjetorit 2025, ajo gjykatë, përkatësisht gjyqtari F.B., shpjegoi se:
- “Padia fillimisht u regjistrua me shenjën e klasifikimit C. nr. 250/1978, dhe me kalimin e viteve lënda mori numra të tjerë, ndërsa numri i fundit i klasifikimit të kësaj të fundit është C. nr. 892/2024, dhe është identifikuar në sistemin SMIL (SUIS) me numrin 2019:131844.*
- Gjatë më shumë se 40 vitesh, kjo procedurë gjyqësore u ndërpre disa herë për shkak të vdekjes së të paditurve dhe pasardhësve të tyre ligjorë. Herën e fundit procedura u ndërpre me aktvendimin C. nr. 616/2023 të datës 12 qershor 2024, për shkak të vdekjes së Murat Ramadan Lushit nga fshati Radostë, komuna e Rahovecit.*
- E mora këtë lëndë, në cilësinë time si gjyqtar, në shtator 2024, pasi mora detyrën time si gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec, dhe unë, ashtu si me lëndët e tjera të vjetra, menjëherë fillova të punoja në të në kohën më të shkurtër të mundshme. Pengesat procedurale në këtë rast i referohen rrethanave të lartpërmendura, duke pasur parasysh se të paditurit dhe trashëgimtarët e tyre ligjorë kanë ndërruar jetë, dhe me vendimin e 6.12.2024, unë e kam refuzuar propozimin për të vazhduar procedurën kontestimore, për arsytet e deklaruar në arsyetimin e atij aktvendimi.*

Shkresat fizike të lëndës, siç thatë edhe ju, janë në proces ankimimi në Gjykatën e Apelit, dhe vendimi i asaj gjykate pritet në lidhje me çështjen në fjalë, për veprime të mëtejshme. Ne nuk kemi qasje në shkresa, prandaj ju udhëzojmë të kontaktoni Gjykatën e Apelit për informacione shtesë.“

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. [...]”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Gjykata i referohet më tej neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

35. Sa i përket përmbushjes së kushteve të lartpërmendura, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston kohëzgjatjen e procedurës në lidhje me lëndën civile [C. nr. 896/2024]. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu theksoi qartë të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës konteston kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore në lidhje me vërtetimin e të drejtave pronësore, e cila ka filluar në vitin 1978 dhe ende nuk ka arritur në një epilog gjyqësor, duke pasur parasysh se është ndërprerë disa herë për shkak të pengesave procedurale, që konsistojnë në rrethanat e vdekjes së të paditurve. Gjykata, duke marrë parasysh natyrën e pretendimit, përkatësisht kohëzgjatjen e procedurës, rikujton se në rrethana të tilla nuk kërkohet të përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 49 (Afatet) të Ligjit, përkatësisht kushtet për parashtrimin e kërkesës brenda 4 (katër) muajve, pasi rasti është ende duke u zhvilluar.
36. Përveç kushteve të parashikuara me Ligj, Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë që:

Rregulli 34
(Kriteret e Pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë te pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

„(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

37. Gjykata përcakton se kërkesa përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (1) të rregullit 34 (Kriteret e Pranueshmërisë) të Rregullores së punës dhe se nuk mund të shpallet e papranueshme bazuar në kushtet e përcaktuara nga paragrafi (2) i rregullit 34 të Rregullores së punës. Përveç kësaj dhe përfundimisht, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të deklarohet e papranueshme në asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme dhe të vlerësohen meritat e saj.

Meritat e kërkesës

38. Gjykata rikujton se nga shkresat e lëndës rrjedh se procedura ka filluar në vitin 1978, kur parashtruesi i kërkesës ngriti padi për të vërtetimin e të drejtave pronësore mbi ngastrat kadastrale të përmendura në zonën kadastrale të Radostës, Komuna e Rahovecit, kundër disa personave të paditur. Më 25 shtator 1986, Gjykata Komunale në Rahovec me Aktgjykimin [C. nr. 221/79] aprovoi kërkesëpadinë dhe vërtetoi të drejtën e pronësisë së parashtruesit të kërkesës mbi parcelat e caktuara. Gjatë rrjedhës së mëtejme të procedurës, lënda u ndërpre disa herë dhe u zhvillua nën numra të ndryshëm për shkak të vdekjes së të paditurve, e më pas edhe të identifikimit të trashëgimtarëve të tyre. Pas mbajtjes së seancave përgatitore gjatë viteve 2022, përkatësisht 2023, procedura u ndërpre sërisht dhe më 12 qershor 2024, Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me Aktvendimin [C. nr. 616/2023], përsëri e ndërpreu procedurën për shkak të vdekjes së njërit prej të paditurve. Më 4 tetor 2024, parashtruesi i kërkesës propozoi vazhdimin e procedurës, mirëpo Gjykata Themelore, me Aktvendimin [C. nr. 896/2024] të 6 dhjetorit 2024, e refuzoi propozimin e tij dhe vërtetoi aktvendimin për ndërprerjen e procedurës, me arsyetimin se identifikimi i trashëgimtarëve të të paditurve ishte obligim i tij si paditës. Më 31 dhjetor 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër aktvendimit në fjalë në Gjykatën e Apelit. Në bazë të informatave të dorëzuara rezultoi se procedura gjyqësore ende ndodhet në fazën e vendimmarrjes lidhur me ankesën para asaj gjykate, e cila deri në ditën e pranimit të të dhënave të fundit ende nuk ka nxjerrë vendim.
39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës së zhvilluar në Gjykatën Themelore, e cila sipas pretendimeve të tij ka zgjatur për më shumë se 40 vite, përbën shkelje të së drejtës së tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse procedura nuk u përfundua brenda një afati të arsyeshëm në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare të një gjykimi të drejtë.
40. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Themelore nuk ka ndërmarrë masa efektive për të përfunduar procedurën, veçanërisht duke kontestuar refuzimin e gjykatës për të vazhduar procedurën për shkak të mosparaqitjes së provave në lidhje me trashëgimtarët e personave të ndjerë në cilësi të të paditurve. Ai gjithashtu konsideron se një arsyetim i tillë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe detyrimin pozitiv të gjykatës për të siguruar zhvillimin efektiv të procedurës, duke theksuar se ai personalisht nuk ka mundur të ndikojë në vonesat e shkaktuara nga vdekja e palëve dhe zbatimin e procedurës së trashëgimisë, dhe se Gjykata Themelore, si autoritet kompetent, ka qenë e detyruar të zhvillojë procedurën në mënyrë efikase dhe pa vonesa të pajustificuara.
41. Gjykata në vazhdim do të trajtojë këtë pretendim të parashtruesit të kërkesës në bazë të parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës së saj gjyqësore, por edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

Parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për vendim brenda një afati të arsyeshëm

42. Gjykata fillimisht rikujton se paragrafi 2 i nenit 31 të Kushtetutës përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme [...]”*.

43. Gjithashtu, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së përcakton se “Çdo person ka të drejtë që [...] të dëgjohet [...] brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë [...], e cila do të vendosë [...] në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij [...] civile [...]”.
44. Prandaj, bazuar në dispozitat e lartcekura, e drejta për një vendim brenda një afati të arsyeshëm është pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
45. Lidhur me këtë, Gjykata tashmë ka një praktikë relativisht të konsoliduar gjyqësore që përfshin por nuk kufizohet në rastet (i) [KI64/23](#), parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023; (ii) [KI06/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022; (iii) [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022; dhe (iv) [KI142/23](#), parashtrues *Fadil Berisha*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2025. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata ka afirmuar parimet e vendosura nga GJENDJ-ja, duke i përfshirë rastet (i) [Poiss kundër Austrisë](#), nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987; (ii) [Abdoella kundër Holandës](#), nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992; (iii) [Comingersoll S.A. kundër Portugalisë](#), nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000; (iv) [Scordino kundër Italisë](#) (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006; (v) [Frydlender kundër Francës](#), nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000; (vi) [Sürmeli kundër Gjermanisë](#), nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006; (vii) [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2006; dhe (viii) [Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë](#), nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019.
46. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, rezulton se: (i) përlllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar; (ii) gjatë llogaritjes merret për bazë procedura në tërësinë e saj, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit dhe procedurën e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor përfundimtar; (iii) arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse dhe veçoritë e secilit rast; dhe se (iv) shteti është i detyruar që të organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së: [Poiss kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 50; [Comingersoll kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafi 24; dhe [Lupeni Greek Catholic Parish dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 142; dhe rastet e Gjykatës [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafët 50-75; [KI19/21](#), cituar më lart, paragrafi 82; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 47).
47. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: (i) kompleksiteti i rastit, (ii) sjellja e palës, (iii) sjellja e autoriteteve shtetërore dhe (iv) rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastin e GJEDNJ-së: [Sürmeli kundër Gjermanisë](#), cituar më lart, paragrafi 128; rastet e Gjykatës [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 65; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 48).
48. Përkitazi me (i) kompleksitetin e rastit, kjo mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen. Thënë këtë, edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendor mund të vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih në mënyrë të ngjashme rastet e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafët 66-

67; [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastet e GJEDNJ-së: [Papachelas kundër Greqisë](#), nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; dhe [Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 210).

49. Përkitazi me (ii) sjelljen e palës në procedurë, nuk kërkohet nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore e as nuk mund të fajësohet pala për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi, megjithatë autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës; nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për ta shtyrë procedurën në favor të tij; dhe se, vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës janë: mungesa e vullnetit për të dorëzuar shkresat, e cila mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës përpara gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së: [Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë](#), cituar më lart, paragrafi 68; dhe [Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës](#), nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i atribuohet autoriteteve shtetërore dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastet e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 68-70; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 50).
50. Sa i përket (iii) sjelljes së autoriteteve kompetente, shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet dhe jo vetëm për sistemin gjyqësor, por edhe për sjelljet e institucioneve publike; gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi; përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë; shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore; mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsye për tejzgjatjen e procedurave; dhe se gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore të tjetra (shih rastet e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 71-73; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 51).
51. Sa i përket (iv) rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve të cilat, për nga natyra e tyre, duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë: rastet që ndërlidhen me statusin; rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët; rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga “*sëmundje të pashërueshme*” dhe kanë “*prirje të reduktuar të jetëgjatësisë*”; rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë; dhe rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit. Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e Gjykatës: [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 74; dhe [KI142/23](#), cituar më lart, paragrafi 52).

Aplikimi i parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

Periudha që do të merret parasysh

52. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se procedura në gjykatat e rregullta kishte filluar në vitin 1978, kur parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi për vërtetimin e të drejtave pronësore mbi ngastrat kadastrale kundër disa personave të paditur. Më 25 shtator 1986, Gjykata Komunale në Rahovec përmes aktgjykimit [C. nr. 221/79] e aprovoi kërkesëpadinë dhe vërtetoi të drejtën pronësore të parashtruesit të kërkesës. Nga shkresat e lëndës rrjedh se procedura u ndërpre disa herë dhe u vazhdua duke përfshirë kërkesën për vazhdim nga viti 1990, si dhe veprime të mëtejshme procedurale pas vitit 2008. Çështja është trajtuar kohët e fundit nën shenja të ndryshme, dhe më 12 qershor 2024, Gjykata Themelore me aktvendimin [C. nr. 616/2023] e ndërpreu përsëri procedurën për shkak të vdekjes së njërit prej të paditurve, dhe më 6 dhjetor 2024, me aktvendimin [C. nr. 896/2024] e refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës për të vazhduar procedurën. Më 31 dhjetor 2024, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, para së cilës çështja është ende në fazën e vendimmarrjes. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se, megjithëse procedura ka filluar në vitin 1978 dhe ende nuk është përfunduar me vendim të formës së prerë, për qëllime të vlerësimit të shkeljes së pretenduar të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, periudha përkatëse që duhet të merret parasysh fillon më 15 qershor 2008, kur Kushtetuta hyri në fuqi, dhe vazhdon deri më 31 dhjetor 2024, kur parashtruesi i parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore. Duke pasur parasysh se pretendimet e parashtruesit lidhen ekskluzivisht me kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën Themelore, Gjykata do ta marrë atë afat kohor si të rëndësishëm për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës në kuptimin e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
53. Njëkohësisht, Gjykata vëren se rasti, bazuar në ankesën e parashtruesit të kërkesës të 31 dhjetorit 2024, është aktualisht në proces të vendimmarrjes në Gjykatën e Apelit. Duke u nisur nga fakti se ankesa kushtetuese i referohet shkeljes së pretenduar të të drejtave për shkak të kohëzgjatjes së procedurës në Gjykatën Themelore, Gjykata thekson se vlerësimi i saj në këtë kërkesë nuk do të paragjykojë në asnjë segment rrjedhën e mëtejshme të procedurës ose vendimin e gjykatave të rregullta, dhe veçanërisht vendimin e Gjykatës së Apelit sipas ankesës së parashtruar.
54. Prandaj, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se rasti i parashtruesit të kërkesës është parashtruar më 22 shtator 2025 dhe ka vazhduar të shqyrtohet edhe pas 15 qershorit 2008, kur Kushtetuta ka hyrë në fuqi, duke përfshirë një periudhë më të gjatë se 17 vjet. Rrjedhimisht, kjo është periudha që Gjykata do ta marrë parasysh (shih rastin e Gjykatës: KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, aktgjykimi i 12 shkurtit 2025, paragrafi 54).
55. Gjykata, për të ardhur në përfundim nëse në rastin e parashtruesit të kërkesës, rasti i tij ishte trajtuar brenda afatit të arsyeshëm, në vijim do të vlerësojë: (i) kompleksitetin e rastit, (ii) sjelljen e palëve në procedurë, (iii) sjelljen e autoriteteve shtetërore, si dhe (iv) rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor.
- (i) Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit*
56. Gjykata rikujton se procedura i referohet vërtetimit të të drejtave të pronësisë mbi ngastrat kadastrale që gjenden në fshatin Radostë, Komuna e Rahovecit. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se përmes aktgjykimit [C. nr. 221/79] të 25 shtatorit 1986, të nxjerrë nga Gjykata Komunale e atëhershme, parashtruesit të kërkesës tashmë i është njohur e drejta e pronësisë mbi ato ngastra. Megjithatë, procedura e cila u vazhdua, veçanërisht në periudhën pas 15 qershorit 2008, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, i

referohej të njëjtit objekt të kontestit si në kohën e ngritjes së padisë fillestare, përkatësisht çështjes së të drejtave pronësore.

57. Gjykata vëren gjithashtu se, megjithëse në ndërkohë u mbajtën disa shqyrtime gjyqësore dhe u morën një numër aktvendimesh, këto veprime lidheshin ekskluzivisht me aspektet procedurale të procedurës, veçanërisht ndërprerjet e procedurës për shkak të vdekjes së palëve të paditura dhe vështirësive në identifikimin e trashëgimtarëve të tyre ligjorë. Vendosja meritore e kontestit nuk pasoi, pasi kushtet procedurale për vazhdimin e procedurës nuk u përmbushën. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kompleksiteti i rastit reflektohet para së gjithash në segmentin e saj procedural, i cili ndërlikohet më tej nga vdekja në vazhdimësi e palëve ndërgjyqëse dhe çështjet e trashëgimisë, të cilat përfaqësojnë rrethana me natyrë objektive që ndikuan në ndërlikimin e procedurës tashmë komplekse për vërtetimin e të drejtave pronësore.

(ii) Përkitazi me sjelljen e palës

58. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se një palë nuk mund të kërkohej të mbajë përgjegjësi për rrethana përtej ndikimit të saj, as të sanksionohet për përdorimin e të drejtave procedurale të përcaktuara me ligj. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës e ka filluar procedurën në vitin 1978, se pas përfundimit të procedurës në vitin 1990, ai ka parashtruar kërkesë për vazhdimin e saj, dhe se në vitin 2011 i ka dërguar një kërkesë Kryetarit të Gjykatës Komunale me qëllim që të ndërmarrë veprime në lidhje me mbrojtjen e pronës së tij dhe vazhdimin e procedurës. Për më tepër, më 4 tetor 2024, ai përsëri ka parashtruar propozim për vazhdimin e procedurës në Gjykatën Themelore, dhe më 31 dhjetor 2024, duke parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit me të cilin propozimi i tij është refuzuar nga gjykata e shkallës së parë. Nga sa më sipër rrjedh se parashtruesi i kërkesës ka përdorur mjetet juridike në dispozicion gjatë procedurës dhe në disa raste ka iniciuar vazhdimin me qëllim që t'i japë fund kontestit.
59. Gjykata gjithashtu merr parasysh se parashtruesi i kërkesës, si paditës, kishte një detyrim procedural për të shënuar palët e paditura, përfshirë edhe trashëgimtarët e tyre. Megjithatë, nga shkresat del se vështirësitë në këtë drejtim ishin rezultat i rrethanave objektive, kryesisht vdekjes në vazhdimësi të personave në cilësinë e palëve ndërgjyqëse dhe komplikimeve të mëtejshme që lidhen me identifikimin e trashëgimtarëve të tyre. Këto rrethana, të cilat nga natyra e tyre ishin përtej kontrollit të drejtpërdrejtë të parashtruesit të kërkesës, nuk mund t'i ngarkohen atij, veçanërisht duke pasur parasysh se vetë gjyqtari përgjegjës për çështjen i kërkoj zyrës kompetente komunale të lëshonte një certifikatë të vdekjes për të identifikuar trashëgimtarin, por as ky autoritet nuk ishte në gjendje të kryente identifikimin. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se sjellja e parashtruesit të kërkesës nuk kontribuoi në zvarritjen e procedurës në periudhën përkatëse.

(iii) Sjellja e autoriteteve kompetente

60. Lidhur me sjelljen e autoriteteve kompetente, Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Gjakovë, në periudhën përkatëse për vlerësim, ndërmori veprime të caktuara procedurale me qëllim të vazhdimin dhe përfundimit të procedurës. Nga shkresat rezulton se lënda mori shenjë të re [C. nr. 47/2019], dhe se seancat përgatitore u mbajtën më 14 tetor dhe 8 nëntor 2022, si dhe më 11 gusht 2023, pas të cilave u morën vendime procedurale për ndërprerjen e procedurës për shkak të vdekjes së palëve të paditura. Më 12 qershor 2024, u nxor aktgjykimi [C. nr. 616/2023] për ndërprerjen e serishme të procedurës. Gjykata gjithashtu konstaton se Gjykata Themelore i ka kërkuar vazhdimisht parashtruesit të kërkesës të specifikojë kërkesëpadinë në kuptim subjektiv, përkatësisht të shënojë qartë palët në procedurë, duke pasur parasysh ndryshimet që

rezultuan nga vdekja e të paditurve të caktuar fillimisht dhe nevojën për të identifikuar trashëgimtarët e tyre ligjorë.

61. Gjykata vëren më tej se më 4 dhjetor 2024, gjyqtari i lëndës, F.B., sipas detyrës zyrtare, i kërkoi Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës së Rahovecit të lëshojë certifikatën e vdekjes me qëllim të identifikimit të trashëgimtarëve të të paditurve të ndjerë. Megjithatë, pavarësisht këtij angazhimi, shërbimi kompetent nuk ishte në gjendje ta identifikojë në mënyrë objektive trashëgimtarin. Në këto rrethana, Gjykata Themelore me aktvendimin [C. nr. 896/2024] e refuzoi propozimin për të vazhduar procedurën, duke konsideruar se identifikimi i të paditurve është në fakt përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës. Bazuar në këtë, Gjykata vlerëson se sjellja e Gjykatës Themelore ishte aktive në kuptimin procedural, megjithatë, masat e ndërmarra nuk çuan në krijimin e një kornize të përshtatshme procedurale-ligjore për vazhdimin dhe përfundimin meritore të procedurës, duke pasur parasysh specifikat dhe kohëzgjatjen e përgjithshme të së njëjtës.

(iv) Përkitazi me rëndësinë e asaj se çfarë është në rrezik për palën në procedurën gjyqësore

62. Lidhur me parimin e rëndësisë së asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor, Gjykata rikujton se sipas praktikës së konsoliduar të GJEDNJ-së, kategori të caktuara të lëndëve kërkojnë kujdes dhe urgjencë të veçantë në veprimet e gjykatave vendase, duke pasur parasysh ndikimin e menjëhershëm që rezultati i procedurës mund të ketë në të drejtat themelore të palës. Edhe pse rasti i parashtruesit të kërkesës, i cili i referohet vërtetimit të të drejtave pronësore mbi pronën e paluajtshme, nuk bie në kategori të tilla siç janë kontestet familjare, marrëdhëniet e punës ose çështjet e statusit, Gjykata konsideron se rëndësia e tij për parashtruesin e kërkesës është padyshim e lartë. Kemi të bëjmë me një kontest pronësor që ka të bëjë me të drejtat pronësore, që përbën një nga të drejtat themelore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, dhe si e tillë gëzon mbrojtje të pavarur kushtetuese.
63. Gjykata thekson se pasiguria afatgjate në lidhje me të drejtat pronësore, veçanërisht në një situatë ku procedura që ka filluar në vitin 1978, ende nuk ka marrë një epilog përfundimtar gjyqësor, ndikon drejtpërdrejt në sigurinë dhe pozitën juridike të parashtruesit të kërkesës. Pa paragjykuar vendimin përfundimtar të gjykatave të rregullta, duke përfshirë procedurat që janë aktualisht në zhvillim e sipër para Gjykatës së Apelit, kjo Gjykatë konsideron se kontesti pronësor i kësaj natyre, i cili edhe pas disa dekadave është ende në fazën e përgatitjeve procedurale para gjykatës së shkallës së parë, tejkalon çdo afat kohor të arsyeshëm dhe të pranueshëm. Një situatë e tillë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashtruesit të kërkesës, pasi kohëzgjatja e tepërt e procedurës vonon zgjidhjen përfundimtare të çështjeve që janë thelbësore për pronën e tij.

(v) Efektet e këtij aktgjykimi

64. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se përfundimi i lartpërmendur i referohet ekskluzivisht kohëzgjatjes së procedurave në lidhje me shqyrtimin e rastit të parashtruesit të kërkesës dhe në asnjë mënyrë nuk paragjykon rezultatin e meritave të rastit së tij para gjykatave të rregullta.
65. Gjithashtu, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së si pasojë e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (shih rastet: [KI19/21](#), parashtrues *Sadik Pllana*, cituar më lart, paragrafi 115; [KI06/21](#), cituar më lart, paragrafi 84; dhe [KI64/23](#), cituar më lart, paragrafi 104).

66. Gjykata përsërit se në disa raste gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të “shpërblimit të drejtë”, sidomos kur parashtruesi i kërkesës ka mundur të pësojë një dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës: [KI113/21](#), parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; [KIo6/21](#), parashtrues *Dragan Mihajlović*, cituar më lart, paragrafi 85).
67. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata thekson se, pas këtij Aktgjykimi, nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm që rasti civil [C. nr. 896/2024] të përmbyllet me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shkurtër kohor, në pajtim me gjetjet e këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullit 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur më 28 prill 2026, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË se ka shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me të drejtën për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- III. T’UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë të njëjtin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- IV. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Safet Hoxha

Nexhmi Rexhepi